



**“INSTINKT... APO PËRCAKTIM
HYJNOR”, NJË KONTRIBUT
ELITAR, QË RREZATON
DITË UDHËZIMI!**



**VLERAT UNIVERSALE
TË PËRCAKTIMIT HYJNOR**



TURPI ËSHTË PREJ BESIMIT

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 6 (232), Qershor, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

Në fenë e të parëve!

*“S’janë vallë muslimanët shqiptar që mbajtën në këmbë
gjer më sot ato zakone të të vjetërve tanë që çuditën botën..?!
Të mos ishin këta ‘tradhtarë’ të fesë, si thonë ca tradhtarë të
mëmëdheut, Shqipëria nuk do të ishte aq e madhe sa është
sot; do të ishte përgjysmë, një e katërta...”*



MYFTIU PRITI DREJTUESIT E UMAD, TURQI

Ditën e shtunë, më 11 qershor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, një delegacion të Shoqatës Ndërkombëtare të Dijetarëve Myslimanë (UMAD) nga Turqia, i kryesuar nga prof. dr. Abdulvehab Ekinxhi.



Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu u njoh me aktivitetin e UMAD dhe njëkohësisht i bëri një prezantim vëllezërve, ku i njohu me Shkodrën dhe aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe sfidat aktuale...

(f. 17)

ZHVILLOHET KONKURSI I 10-TË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE TË SHKODRËS

Ditën e shtunë paradite, më 25 qershor 2022, në ambientet e kompleksit “Zmijani”, Myftinia Shkodër organizoi, përmes sektorit të arsimit, aktivitetin e madh të Konkursit të 10-të vjetor midis kurseve fetare, që zhvillohen në xhamitë e Shkodrës.



Ky aktivitet madhështor mbledhi mbi 750 nxënës nga 45 xhami të qytetit dhe fshatit, dhe sipas programit të parashikuar, filloi me fjalën e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi iu uroj mirëseardhjen nxënësve frekuentues...

(f. 10)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Kohë më parë, kur imami dhe thirrësi islam Lavdrim Hamja më lajmëroi se kishte nisur të përkthente në shqip një libër të ri nga prodhimtaria e autorit të shquar damasken, Dr. Sheuki Ebu Khalil, menjëherë më erdhën ndër mend disa prej veprave të tij, më të cilat jam rritur gjatë viteve të studimeve në Damask.

Shpejt e shpejt para syve u shfaqën botime me vlerë të autorit, si: “Islami në bankën e të akuzuarve” (Damask, 1996), “Hixhreti, ndodhi që ndryshoi rrjedhat e historisë” (Damask, 1979), “Njeriu ndërmjet shkencës dhe fesë” (Damask, 1989), “Harun Reshidi, prijësi i hulefave, më i madhërishti i mbretërve të botës” (Damask, 1996), “Mendime që Islami demaskon!” (Damask, 1996), “Islami dhe lëvizjet çlirimtare arabe” (Damask, 1991), etj.

Më gëzoi fakti se libri që kishte marrë mbi supe të na sillte në gjuhën tonë, ishte një xhevahir i munguar në xherdanin e veprave që i drejtohen arsyes dhe logjikës së shëndoshë, për t’i ngacmuar drejt të vërtetave të mëdha të besimit. Tamam, si libri tjetër, që Hamja pat mirësinë të na e sjellë

“INSTINKT... APO PËRCAKTIM HYJNOR”, NJË KONTRIBUT ELITAR, QË RREZATON DITË UDHËZIMI!

në shqip: “Dialog me mikun ateist”, të mendimtarit egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud.

Si të thuash, këta dy libra qëndrojnë përkrah njëri-tjetrit, si një përpjekje intelektuale elitare për të ftuar mendjen e këtij shekull drejt zgjimit nga hutimi dhe tymnajat dehëse të shkaktuara nga lëvizjet ateiste dhe propaganda femohuese, që e do njeriun të zhveshur nga besimi dhe, gati-gati në kufijtë e një manekini të heshtur, lëvizjet e të cilit programohen nga jashtë dhe që nuk asnjë të drejtë a mundësi të jetë dikush, qoftë edhe në vetvete.

Gjatë punës për redaktimin e këtij botimi që sot, kemi mirësinë të kemi në dorë, kam notuar në detet e thella të mendimit dhe arsytimit të lirë e të pastër qytetërues të autorit Ebu Khalil, që nëpërmjet argumenteve shkencore dhe analizave të holla e të detajuara me mjeshtërinë e dijetarit, arrin të na sjellë para duarve detaje të jashtëzakonshme, emra krijesash, (shpesh edhe të panjohura), që jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre të përditshëm në këtë botë, afër nesh, por edhe larg, duke dëshmuar me praninë e tyre mrekulli prej mrekullive të krijimit.

Fjala bie: “Ndërtimin inxhinierik të ndërlikuar në ndërtimin e shtëpive (foleve), digave (pendave) dhe urave, siç ndodh tëk merimanga, qeni i ujit, etj. Depozitimin dhe sigurimin e ushqimit për të ardhmen, siç ndodh tek buburrecat, bleta, ketri, etj. Dhembshurinë për të vegjlit, siç ndodh tek ariu, kastori, elefanti, etj. Zgjuarsinë

për të aktruar dhe bërë hile, siç ndodh tek bretkosa me brirë (antena), etj. Specializimin për t’u fshehur dhe kamufluar, siç ndodh tek qyqja, gaforrja vetmitare, etj.”

Autori, bën një konstatim të madh, kur dëshmon se: “E kemi bërë zakon, që kafshët t’i shikojmë sikur ato janë kafshë grabitqare të egra. E, ky është gabim i madh! Nëse bëjmë një krahasim mes kafshëve dhe njeriut, atëherë do të dalë e kundërta e kësaj.

Kafshët vrasin për të jetuar, me instinktin e ruajtjes së jetës, dhe sikur të mos ishte ky instinkt, kafshët do të ishin zhdukur nga ekzistenca.

Ndërsa njeriu, nuk heq dorë nga instinkti i derdhjes së gjakut. Njeriu është gjakderdhësi më i madh, sepse ai vret çdo ditë miliona shpendë e kafshë, me të cilat shuan urinë e tij. E. megjithatë, ai nuk është i kënaqur me këtë, sepse ai shumë herë gjuan peshk, shpend e kafshë për kënaqësi (hobi) dhe e quan këtë dëshirë për vrasje: sport për trupin!”

Libri që kemi para duarve, përveç njohurive të shumta dhe detajeve të bollshëm nga jeta e shumë insekteve, shpendëve, peshqve e kafshëve të ndryshme, mund të konsiderohet shumë mirë edhe një enciklopedi e botës së gjallë, ku lexuesi, përtej impulseve që i ngacmojnë logjikën dhe e tërheqin drejt besimit, mëson edhe për krijesa magjepsëse më sjelljet dhe natyrën e tyre.

Aty do të gjejmë: dallëndyshen e detit, lejlekun që fluturon deri në

NË FENË E TË PARËVE...

Kujtesa popullore e Shkodrës na sjell fjalët e veprimtarit dhe intelektualit të Rilindjes, Mati Logoreci (1867-1941), mësues i shkollës së parë shqipe në Prizren (1888): “Ne katolikët (shqiptar) ekzistojmë në sajë të myslimanëve. Po të mos ishin myslimanët, sllavët prej kohësh do të na kishin asimiluar ose do të na kishin përzënë prej këtej.”

Po kështu, kishte shkruar më 1900 edhe një i krishterë korçar: “S’janë vallë muslimanët shqiptar që mbajtën në këmbë gjer më sot ato zakone të të vjetërve tanë që çuditën botën..?! Të mos ishin këta ‘tradhtarë’ të fesë, si thonë ca tradhtarë të mëmëdheut, Shqipëria nuk do të ishte aq e madhe sa është sot; do të ishte përgjysmë, një e katërta, nga shkaku i Shqehvet... Myslimanët shqiptar i vunë frenë përhapjes së detit shqah... Myslimanët e sotëm janë ata që i apin Epirit karakter shqiptar.”

Edhe Dom Nikollë Mazreku në demaskimin e demagogjisë së Cordignano’s i thoshte se: “nëpërmjet Islamit nuk është shkombëtarizuar



asnjë krahinë etnike shqiptare; një meritë dhe një arritje tejet e madhe.”.

Qytetet dhe fshatrat kishin xhami e kisha, por asnjëra me ceremonialet dhe ritet e saja, me pamjet e angazhimit e tyre, nuk pengonin njëra-tjetrën, nuk e prishnin qetësinë për qytetarin e cilitdo besim. Kështu, në mesin e shqiptarëve zotëronte një tolerancë për çdo lëvdatë!

Misionarja amerikane Delfe Davis shkruante se të gjithë elementët

kristianë të Manastirit, deri në vitin 1912, gëzonin liritë e plota fetare, ndërkohë që Kostandin Çerkezi shkruante se të krishterët dhe muslimanët e Shqipërisë kishin marrëdhënie shumë më të mira se katolikët dhe protestanët e Evropës së qytetëruar.”.

* Hajrudin S. Muja, “Në fenë e të parëve”, LOGOS-A, Shkup, 2013, f. 38-39.

(fb: Imam Muhamed B. Sytari)

2

8 mijë km për të kërkuar ushqimin e tij të preferuar, zogun e vogël të pushkës, sqeplugën, sqepkryqëzuarin, papagallin, flamengon, zogun gojëbretkosë, qëruetin, gushkuqin, shqiponjën e artë, arasarin ngrënës të frutave, kukapikun, zogun gumëzhues, gazelen e kuqe skoceze, limingun, që i ngjan miut, harabelin, ploverin e artë që shtegton nga skaji verior i tokës për në skajin jugor të saj, 8 mijë milje (12280 km), ujëgërshërin madhështor, dallëndyshen e arktikut, bubulinkun që shtegton nga Kanada për në Argjentinë me një distancë afërsisht 7 mijë milje (11270 km), bishtlëkundësin, buklën, gaforren, ariun e bardhë, majmunin dembel, ngjalën e detit, salmonin, gjarpërinjtë elektrikë të ujit, që jetojnë në ujërat e pastra të Brazilit dhe Guinesë, “gjatësia e të cilëve arrin 210 cm... godet me rrymë të fuqishme, e cila mund të arrijë në 5000 volt”, etj.

Mësojmë gjithashtu se: “Ekzistojnë shumë peshq, që dërgojnë sekuenca të ndryshme drite prej trupit të tyre, për të ndriqur rrugën. Ka gjallesa të tjera, në formë ylli, të pajisura me dritë jeshile, ngjala deti, që lëshojnë dritë

elektrike të bardhë; gaforre, të cilat kanë brirë (antena) orientuese, që prej tyre nxjerrin valë drite blu. Krijesa të tjera, si fenerë të vegjël, që lëshojnë në ujë shkëndija drite të verdhë, të kuqe dhe jeshile.

Këto krijesa ndriçuese jetojnë në thellësi 1200 metra nën ujë. ... Ekzistojnë edhe disa peshq të tjerë të mëdhenj e të frikshëm, që lëvizin si grumbull flake... dhe në disa raste tubohen në disa vende në grumbuj të mëdhenj, me qindra miliona të tillë dhe krijesa të tjera ndriçuese të vogla, duke e kthyer fundin e detit si një shtroje e ngjashme drite.”

Pas shfletimit me kërshëri të faqeve të librit, vjen një moment kulminant, kur autori pyet: “Pa tërë kësaj, le të kthehemi tek parathënia e këtij libri dhe të themi: Nuk është natyra, ajo e cila ka shpikur (krijuar), se ajo nuk përgatit, nuk krijon, nuk ekuilibron, nuk ndihmon, nuk pajis, nuk përsos veprimet, nuk dhuron dhe, ajo nuk ka lavdi! Vetë natyra është e krijuar dhe ajo është e paaftë të veprojë!

Ajo që pamë, gjatë fletëve të këtij

libri, është Përcaktimi Hyjnor, shpikja e krijimit të Allahut të Madhëruar: ‘Dhe, këto shembuj, Ne i sjellim për njerëzit, e ato nuk i kuptojnë, vetëm se të diturit!’ – (Kur’ani, El-Ankebut: 43)”.

Pa dyshim, vepra: “Instinkt... apo përcaktim hyjnor?”, mbetet një kontribut i vyer që na shërben të gjithëve, na vlen e na frymëzon drejt madhështisë së besimit në Një Zot, ndjekjes së Dritës së Tij në jetë dhe falënderimit që na bëri mëkëmbës të Tij, duke na pajisur me mendje, të cilën e furnizoi dhe e fortifikoi për të mirën e njerëzimit dhe gjithësisë me shpalljet hyjnore!

Përkthyesit, të nderuarit H. Lavdrim Hamja, i uroj suksese dhe mbarësi në një rrugë të gjetur prej tij, për tëna sjellë herë pa here e vit pas viti, botime me vlerë nga autorë elitare, në praninë e të cilëve ngelemi nxënës të magjepsur para fiksimit të diellit të dijes, udhëzimit, urtësisë dhe qytetërimit islam!

Faleminderit!

Shkodër, më 17 qershor 2022



H. Burhan Fili
Thirrës Islam - USA

Grumbullimi i popullsisë në qytet të madh siç është rasti i Tiranës, i përngjet një ‘rezervati’ ku grumbullohen “gjallesat” në mënyrë që gjuetia e tyre të bahet e lehtë. Aty humbet ‘adresa’ që çon në daljen nga natyrshmëria me të cilën u krijun, kjo çon në hibritizim që është shkarje drejt shkatërrimit.

Grumbullimi i popullsisë në një qytet (Tiranë), e mpin ndërgjegjen, pakson kureshtjen, e zbeh vizionin dhe e shkëput njeriun nga themeli i tij. Largimi i popullsisë nga fshatrat, qytetet e vogla, krijon boshllëk dhe tharjen e burimit natyror që mban gjallë dhe të freskët lidhjen në mes fshatit dhe qytetit pa e cënu rrjedhshmërinë e rrjedhës shoqërore, që mban ekuilibrin e infrastrukturës shoqërore, e cila po grryhet nga vërshimet e popullsisë nga katundet në një rezervat të qëllimtë, duke kriju erozion, i cili gryn përbamjen shoqërore, që po del nga natyrshmëria e saj.

BRAKTISJA E PLANIFIKUME

Kjo nuk bahet rastësisht, por mungesa e kushteve qëllimisht si mungesa e infrastrukturës dhe papunësia në maksimum çojnë në braktisjen e fshatrave dhe qyteteve të vogla.

Të gjitha kto bahen me plane të caktume për të çorodit popullin me busull të humbun, që harron nga ka ardhë. Në atë amull shoqëror ku i ka humb freskia dhe ripërtëritja që krijon ambientin ku zhvillohen ‘viruset’ e korrupsionit e të gjitha formave në të gjitha sferat e jetës të çoroditun.

Dyndjet e popullsisë në kyt formë janë rrezik i madh për një komb, se janë jashtë natyrës së lëvizjes që një popull ndërmerr në kushte normale, me përjashtim të luftrave që çojnë në largimin masiv të popullsisë, refugjatë.

Ndërsa këtu në Tiranë po bahemi refugjatë të korrupsionit të planifikum që ka sjell mishmash, ku s’e merr vesht i pari të fundit. E gjitha kjo ka sjellë dehjen e popullsisë që dyndet në qytetin e madh “El Salvador-Shpëtimtar” -Tiranën, rezervati i korrupsionit të kombit, që të gjithë hyjnë me dëshirën dehëse...

Boshatisja e fshatrave, qyteteve të vogla bjen varfërinë e kombit, duke dobësuar marrëdhëniet e natyrshme që mbajnë ekuilibrin e popullsisë. Lëvizjet e njerëzve nga vendi në një vend nuk mund të ndalohen siç bani

komunizmi, ato duhet të lihen të lira që të qarkullojnë natyrshëm, kjo sjellë ruajtjen dhe mbrojtjen nga erozioni i bastisjeve të vendit, që nëse vazhdohet kështu do të sjellë shterpëzimin e popullsisë që duket se po shkon haravan drejt saj...

Kjo nuk është thjesht dukuri, por fatkeqësisht është realitet i hidhur që ka gllabru vendin tonë dhe vende të tjera që i përngjasin kampeve “refugjatësh” ku presin mundësinë e arratisjes...

Nëse vazhdohet kështu Shqipëria do të bahet shterp, thjesht një rezervat për të furnizuar tregjet e korrupsionit të brendshëm e të jashtëm që punojnë për njena-tjetrën në kurriz të kombit tonë.

Ky rrezik që po i kanoset shqiptarve nuk mund të luftohet ndryshe vetëm duke qenë të ndërgjegjshëm për amanetin që kemi: ta ruajmë vehten tonë me vehten tonë duke forcuar besimin në Zot që na nderoi me kombin, gjuhën dhe vendin tonë që janë amanet.

Kjo do të sjellë imunitetin tonë për t’i ba ballë sulmeve të virusëve të vendit e të huaj, që prodhohen nga moçalishtja e korrupsionit ndërkombëtar.

Shqipëria nuk është Tirana, por Tirana është e Shqipërisë.

Allahu na ruajtë të gjithëve!

Tiranë

22/06/2022

KY RREZIK QË PO I KANOSËT SHQIPTARVE NUK MUND TË LUFTOHET NDRYSHË VETËM DUKE QENË TË NDËRGJEGJSHËM PËR AMANETIN QË KEMI: TA RUAJMË VEHTEN TONË ME VEHTEN TONË DUKE FORCUE BESIMIN NË ZOT QË NA NDEROI ME KOMBIN, GJUHËN DHE VENDIN TONË QË JAMË AMANET.

SINQERITETI, THELBI I FETARIZMIT!

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takon vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë. Salavatet dhe selamet ma të përzemërta ia dërgojmë më të mirit dhe më të shtrenjtut të krijesave të Allahut (xh.sh) Hz. Muhammedit (a.s), i cili me shembullin e tij na mësoi se njeriu me atë çfarë i ka dhënë Allahu (xh.sh) në këtë botë mundet me e praktikuar Islamin dhe ky Islam nuk është i rëndë, se ky Islam nuk është i zorshtë, nuk është i sikletshëm, nuk është i vështirë!

O nuk mundem ta bëj, si ta bëj? Këtë nuk e bën njeri! Jo, e ka bërë Pejgamberi (a.s), që është njeri. “Thuaj unë jam njeri sikurse ju, mua më shpallet”, citohet në fund të sures El-Kaf.

Të dashurit e mi, kemi nevojë që ta praktikojmë Islamin tonë dhe ta dëshmojmë Islamin në çdo hap të jetës. Ta shoqërojmë me sinqeritetin atë, që Allahu (xh.sh) e ka kërkuar në shumë vende në Kuranin Famëlartë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë një fjalë që është vendosur në krye të të gjithë librave të jurisprudence islame. Librat më të rëndësishëm të diturisë islame fillojnë me këtë hadith: “Veprat shpërblehen sipas nijetit!”.

Sikurse thonë të parët tanë se mund të jetë një punë shumë e vogël që njeriu e zmadhon tek Allahu (xh.sh) dhe ti mund të bësh një punë shumë të madhe, mirëpo njeriu yt i mangët e shumëzoi me zero dhe nuk peshon asgjë tek Allahu (xh.sh).

Kemi nevojë që të përmirësojmë cilësinë e nijetit dhe të kontrollojmë se sa jemi të sinqertë në marrëdhënie me Zotin tonë. Sa jemi të sinqertë kur flasim për Islamin dhe dëshmojmë si muslimanë aty ku na ka vendosë Zoti në jetë, ti tregtari, ti mjeku, ti myftiu, ti imami, ti inxhinieri, ti arkitekti, ti nxënësi, ti studenti, ti nënë, ti studentja, ti inxhinierja, ti avokatja, ti gjyqtarja, e kështu me rralë.

Kurani në disa vende na tërheqë vëmendjen duke thënë: “Ne ta kemi zbritur ty këtë libër me të vërtetën, prandaj adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë”. Me durimin tënd me fetarizmin tënd, me sinqeritetin që të bën të dallosh nga një kategori njerëzish, për të cilët në Kuranin Famëlartë lexojmë: “Munafikët janë atje

në fund të zjarrit”. Grada më e ulët dhe poshtërimi më i madh që i bëhet dikujt në ditën e gjykimit, për atë çfarë ka bërë në këtë botë për sjelljen e tij është kategoria e munafikut, hipokritëve.

Njerëz që shkonin me Pejgamberin (a.s), shkonin mbas tij, përziheshin me sahabët në mexhliset e Pejgamberit (a.s), mirëpo në zemër ishin zero, në zemër nuk kishin asgjë.

Nëse ti je i sinqertë me Allahun (xh.sh) krejt bota me të paragjyko, ti je triumfues, duro se një ditë do të dalë e vërteta jote në shesh. Nëse do të jesh i sinqertë me Allahun (xh.sh) dhe krejt bota të jetë kundër teje, ti do të jesh fitimtar. Ti ke fituar Allahun, por çfarë peshe ka krejt bota me Allahun në këtë përlllogaritje? E nëse ti ke humbur Zotin tënd, çfarë peshe ka krejt bota në krahun tënd? Një ditë, një vit apo dhjetë vite me pozitë, pasuri me emër të madh dhe pastaj...!?

Shkoni e vizitoni varrezat, kudo që shkoj kam dëshirë të vizitoj varrezat dhe shoh emra të mëdhenj, emra të vegjël, emra anonim, emra të njohur, komshinj, të afërm, të largët, pasanikë, varfanjakë, etj, etj. Dikë, që dikur e kemi ndihmuar, dikush që vinte dhe bindte për të ndihmuar të tjerët, të gjithë atje barazohen.

Mirëpo çfarë bëjnë, që ata të dallojnë nga njëri – tjetri nesër kur të kalojnë atë prag? Sinqeriteti, ajo që ka qenë në zemër dhe që ka qenë për Allahun nuk humbet asnjëherë. Shumëfishohet dhe rrezaton dritë në të përtejmen.

Allahu (xh.sh) thotë: “Se drita e tyre përhapet nga të gjitha anët”, ndërsa e kundërta me të kundërtën, Zoti na ruajtë.

Sinqeriteti, të dashurit e mi, atë që e bëjmë, ta bëjmë për hir të Allahut dhe të mos presim nga kush asgjë. Atë që e bëjmë ta bëjmë me zemër të madhe të bindur se tek Allahu (xh.sh) nuk humbet asgjë dhe i lumi ai që i përkushtohet Zotit të tij me sinqeritetin e zemrës dhe e dinë shumë mirë se tek Allahu nuk ka zullume. Zoti nuk i bën zullum askujt!

Allahu (xh.sh) do të të shpërblejë edhe për një grimcë të vogël. Ai që bën një grimcë të vogël, hajr të mire, do ta shohë të mirën e saj dhe e kundërta. A nuk e lexojmë shpesh herë në Kuran këtë?

Pse i lexojmë këto ajete dhe nuk

reflektojmë rreth tyre?

Pse i lexojmë këto ajete dhe bëjmë të kundërtën e tyre? Allahu na udhëzoftë!

Allahu (xh.sh) na thotë se sinqeriteti është e vërteta e fesë, është thelbi i fetarizmit. Feja që bazohet mbi sinqeritetin është ajo që pranohet tek Allahu (xh.sh) e thotë në Kuran pa e vendosë fetarizmin tonë mbi shinat e sinqeritetit dhe pa e ulë gjithsecili prej nesh sjelljen e tij mbi Arshin e sinqeritetit; asgjë nuk është fetarizmi i tij dhe asgjë nuk është vepra e tij sado e madhe qoftë ajo. Edhe nëse krejt njerëzit të duartrokasnin të vlerësojnë e flasin mirë për ty, tregojnë me gisht e shkruajnë për ty, e të thurin vargje, etj, etj, pa fund. Jo, nuk ka vlerë asgjë e njerëzve nëse ti nuk i ke marrëdhëniet e sinqerta me Zotin tënd, me Allahun (xh.sh). E nëse e ke marrëdhënien e sinqertë me Zotin tënd, leni njerëzit në punën e tyre dhe mos u merr fare me çfarë thonë njerëzit dhe çfarë veprojnë.

Pejgamberi (a.s) urdhëron dhe thotë: “Me të vërtetë Allahu nuk e pranon asnjë vepër, që nuk është e sinqertë për hir të Tij dhe që nuk veprohet për të fituar pëlqimin e Tij”, që do të thotë se edhe në gotën e ujit që unë e marr dhe me zemrën time dhe me njetin tim them do ta pijë këtë ujë për t’u forcuar për adhurimin, për t’u forcuar në këtë ligjërim, që të dalë fjala sa më e mirë për hir të Allahut (xh.sh), unë shpërblehem dhe për një pikë ujë.

Prandaj thotë Resulullahu (a.s): “Nuk ka shpenzuar njeriu diçka më të mirë, se sa për familjen e tij, dhe kafshatën që e vendosë në gojën e gruas së tij dhe gotën e ujit”. Një gotë ujë që ti ia jep bashkëshortes tënde, ose prindit, sepse babën dhe nënën i kemi mbi bashkëshortet dhe mbi bashkëshortët.

Atë çfarë e bëjmë ta bëjmë me sinqeritet, të dashurit e mi, sepse sinqeriteti është karta që nuk digjet asnjëherë dhe na nxjerr faqebardhë para duarve të Allahut (xh.sh) në këtë botë e përtej saj, në të përtejmen. Allahu ju dashtë!

Amin!

Hytbeja e xhumasë
nga Myftiu i Shkodrës,

Imam Muhamed B. Sytari,

në xhaminë e “Dy Vajzave”, 24 qershor 2022

Diktoi tekstin: Siditë Hafzi



Xhahid Bushati, shkrimtar

Optika e shikimit dhe e marrëdhënies me një vepër është e ndryshme, ka shtresëza njohje e mosnjohje, ka cektësi dhe thellësi mendimi e vlerësimi. Kjo, sigurisht, është e lidhur me kulturën, dijet, studimtarinë, inteligjencien, njohjen e gjuhëve të huaja, përgatitjen dhe cilësitë personale... etj. etj. Të njëjtën vepër (siç është në rastin tonë “Instinkt... apo përcaktim hyjnor?”), ndryshe e lexon një lexues i zakonshëm, ndryshe një studiues, ndryshe një teolog, ndryshe një ateist, ndryshe e ndryshe... Pavarësisht të ndryshmeve në rrugët e tyre, ajo që i bashkon është gëzimi dhe urimi për këtë vepër të sapoardhur në sofrën e begatë të diturisë Islame dhe të bibliotekës së saj që çdo ditë shtohet e ndriçohet nga libra të tillë të vlefshëm e që kanë natyrën e dijetarit. Mendoj, që teologu Lavdrim Hamja në zejen e përkthyesit e të dijetarit, këtë mision që është sa delikat dhe i vështirë e ka kryer me sukses. Por, nga ana tjetër, Institucioni i Myftinisë së qytetit tonë, me seriozitetin e tij, krahas librave të tjerë që ka botuar në vite, kësaj radhe është një libër interesant, me një problematikë delikate, pyetësore e argumentuese. Ky libër për materialin që mbart e shtjellon mbart dekada pune sistematike, kërkim shkencor e të vërteta nga ana e autorit. Në themel qëndron ballafaqimi, krahasimi i raporteve mes reales e hyjnore. Në fund problemi që shtrohet është bindës dhe fitues. Libra me një univers të tillë, në realitetin tonë ekzistues të trazuar, i duhen bibliotekës shqipe dhe në veçanti Bibliotekës Islame. Sepse në profilin e këtij libri, e çuditshmja është reale dhe përkatësia hyjnore ka funksion: udhëzues, veprues, besues dhe vazhdimësi jete.

Në librin e botuar pak kohë

VLERAT UNIVERSALE TË PËRCAKTIMIT HYJNOR

-Shënime për librin “Instinkt... apo përcaktim hyjnor?” të autorit Dr. Sheuki Ebu Khalil”, përkthyer nga arabishtja dhe përshtatur në shqip nga teologu Lavdrim Hamja, botues Myftinia – Shkodër, 2022-

më parë, i ardhur në përkthimin pasionant të Lavdrimit, që titullohet: “Instinkt... apo përcaktim hyjnor?” rrëfimet, argumentet, ritualet jetësore e ekzistenciale të personazheve, nganjëherë duken e ngajnë përrallore por janë të vërteta e bindëse. I bashkëshoqëron një informacion i pasur shkencor. Ndërsa në gjithë strukturën e godinën tekstore të librit, bëhet një pyetje e vetme me dimension universal, të cilën e mbart titulli i librit. Vërtetë, gjatë tekstit ndeshemi me pyetje të tjera, por ato janë në funksion të pyetjes themelore. Gjatë leximit të ekstursës së tekstit ndeshemi me shembuj jetësorë, konkret e realë. Këto shembuj-modele të marrë nga universi i jetës, ku ndodhitë e tyre vizatohen e jetësohen nga autori me vërtetësi, mendoj që lexuesin, shpesh, e futin në dilema, në të papritura dhe në pyetjen: “si ka mundësi?!”; i duken të pabesueshme po ja, që jetën e



përditshme ndodhin...; e futin në rrugën e mendimeve, nganjëherë nuk arrin të kuptojë “të fshehtën” e dukurisë apo të fenomenit... etj., etj. Të gjitha këto pyetje e dilema kanë një zgjidhje, një të vërtetë, sepse zgjidhjen e të vërtetës e realizon universi hyjnor. Duke qenë i tillë, krijesat që janë marrë si shembuj veprojnë ‘sipas porosive të tij hyjnore’. Ndaj, ky libër në përmbajtjen e tij shfaq mrekulli besimi.

Libri në çdo rrëfim e pjesë të tij është i plotësuar mjeshtërisht, sa autori thotë: “Të mençurit i mjaftojnë disa argumente,

dhe ai bindet!” Përse e thotë autori? E para, ekzistenca e kafshëve, shpendëve e kandrrave është reale në jetën e tyre dhe ata kanë mënyrën e jetësës, ritualin dhe botën e tyre. E dyta, dhe që është vendimtare e që duhet besuar autori, e gjejmë në thënien e tij: “Përkujdesjen hyjnore, përsosmërinë, mrekullinë e Zotit dhe përcaktimin e urtë, dijetarët e kanë gjetur krejt qartë dhe dukshëm, në qindra e mijëra qeliza të detyruara, që të bëjnë gjënë e drejtë: në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Shpresoj, lexues i nderuar, të gjeshe edhe ti gjithashtu këtë gjë. Ky ka qenë qëllimi im në këtë libër.

Allahu i Madhëruar thotë: “I Cili përsosi çdo gjë, që krijoi...” – (Kur’ani, Es-Sexhde: 7).

“I Cili krijoi dhe përsosi dhe I Cili përcaktoi dhe udhëzoi”. – (Kur’ani, El-E’ala: 2 -).

Çdo pjesë e këtij libri të vlefshëm, është sa tokësor aq hapësinor, sa tërheqëse e aq mësimdhënëse. Çdo pjesë i ngjan një guri të çmueshëm me rrezatim përkatës e të gjithëkohshëm. Unë zgjodha njërin prej tyre për t’i shtjelluar... Titullohet “Shtegtimi”, me një nëntitull kuptimplotë, që është i pranishëm në çdo vatër tonën familjare, siç është: “Malli për vatanin”.

“Dhe, krijoi çdo gjë, e Ai për çdo gjë është Dijshëm” – Kur’ani, El-En’am: 101)

Teksti, në pikëpamje kohore, na çon në fund të shekullit të 15-të dhe në fillim

të shekullit 16-të. Këtu vendoset ngjarja.

-Teza e autorit është: Njeriu nuk i dinte të gjitha skajet e botës, ndërsa shpendët e dinin botën shumë kohë përpara njeriut.

-Personazhet që janë të pranishëm në këtë pjesë, e që njihen deri në detaje gjeografike, biologjike e jetësore nga ana e autorit. Ato janë: skoi, frigata, dallëndyshja e detit, ploveri i artë, lejteku e papagalli i verbër. Këto janë shpendë shtegtues.

-Argumentet e autorit: “Këto shpendë shtegtues nuk kanë nevojë për udhëzues që i udhëzon rrugën, për të ndjekur udhëtimin e tyre – vajtje-ardhje. Sikur ato zotërojnë ndonjë manual që nuk gabon, madje zotërojnë ndjesi të habitshme, që i udhëzojnë në rrugën e duhur.

-Figura e Lejtekut? Autori për lejtekun na thotë: “Ai fluturon në dimër nga Gjermania, Holanda dhe Austria, me një distancë prej 8 mijë km. Fluturon... deri në mesin e Afrikës, pastaj në Afrikën e Jugut, ku kërkon për karkalec, ushqimin e tij të preferuar. Kush e frymëzoi atë se sofa e tij e preferuar e oreksit është atje, mijëra kilometra larg?!” Sigurisht kjo pyetje e ka një përgjigje., - përfundon autori frazën e tij.

-Teksti mbyllet me figurën e papagallit të verbër. Si një epitaf për papagallin shkruhet: “Papagalli jetëgjatë, ku çdo vit udhëton për në Amerikë dhe kthehet prej saj çdo vit... e ai është i verbër”.

-Dhe autori, tekstin e tij, e përfundon me pyetjen (pyetjet janë tipologji e librit) “ – A ke pyetur: Si e ka ditur ky papagall i verbër rrugën e tij, pa humbur vendet e ngrohta?! Njeriu i verbër, nuk mund të ecën, veç me ndihmën e shkopit, dhe sa herë që ecën pak, pyet dhe kërkon për rrugën e tij. Ndërkohë, papagalli i verbër: Përshkon mijëra kilometra, pa pasur nevojë për atë, që njeriu i verbër ka nevojë?! Si mund të arrihet kjo gjë?!” Sigurisht kjo pyetje e ka një përgjigje.

Dhe pyetje me një tipologji të tillë thelbësore e kureshtare janë plot në këtë libër. Përgjigjet e sakta i keni brenda shpirtit tuaj, i dashur lexues, brenda aktit të besimit hyjnor. Gjeni të shkruar në këtë libër përgjigjet e vërteta, të sakta e të besueshme. Sepse, Urtia Kur’anore thotë: “Dhe, krijoi çdo gjë, e Ai për çdo gjë është i Dijshëm” – (Kur’ani, El-En’am: 101).

Shkodër, qershor, 2022

PROMOVHET LIBRI: "INSTINKT... APO PËRCAKTIM HYJNOR",

i autorit Dr. Sheuki Ebu Khalil, përkthyer nga teologu Lavdrim Hamja

Ditën e xhuma në mbrëmje, më 17 qershor 2022, në oborrin e xhamisë “Ebu Bekër u promovua libri: “Instinkt... apo përcaktim hyjnor”, i autorit Dr. Sheuki Ebu Khalil, përkthyer nga teologu Lavdrim Hamja.

Në këtë aktivitet merrni pjesë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, imamë, teologë, intelektualë dhe pjesëmarrës të tjerë, dashamirës të librit.

Aktivitetin e hapi teologu Arben Halluni, i cili pasi bëri një përshkrim të shkurtër rreth librit në fjalë, ftoi për të folur Myftiun, Imam Muhamed B. Sytari.

Myftiu mbajti temën: “Instinkt... apo përcaktim hyjnor”, një kontribut elitar, që rrezaton dritë udhëzimi! - i cili hodhi dritë mbi rëndësinë e librave të autorit Dr. Sheuki Ebu Khalil, si një studiuës elitar, ku gjithmonë sjell për lexuesit

libra me dobi e vlerë dhe të mbushur plot me argumentet bindëse.

Më pas fjalën e mori, shkrimtari Xhahid Bushati, i cili ligjëroi temën: “Vlerat universale të përcaktimit hyjnor - Shënime për librin “Instinkt... apo përcaktim hyjnor?”.

Shkrimtari Bushati bëri një analizë letrare të librit dhe argumenteve të ndryshme në këtë libër, duke sjell pasazhe prej tij.

Në fund, fjalën e mori përkthyesi i librit, teologu Lavdrim Hamja, i cili pasi rrëfeu shkurtimisht jetën e autorit u ndal tek rëndësia e librit, si një dritë rrezatuese për secilin njeri, që dëshiron të kuptojë se çdo gjë është krijuar nga Zoti i gjithësisë dhe secilës krijesë i ka përcaktuar programin e jetës së saj.

Aktiviteti përfundoi me shpërndarjen e librit për të pranishmit.





Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu (xh.sh) i ka dhënë njeriut disa forca frenuese në mënyrë që të ketë mundësi ta frenojë vetveten në situatë të caktuara. Për aq kohë sa funksionojnë këto forca frenuese njeriu e udhëheq dhe e menaxhon vetën e tij.

Ashtu sikur ligjet e caktuara që janë një formë e jashtme frenuese për njeriun po ashtu edhe turpi është një forcë e brendshme, që e frenon njeriun, e mëson atë që ta kontrollojë dhe menaxhojë vetveten. Turpi është çelësi i çdo të mire dhe njësisë matëse e shëndetit të një shoqërie.

ÇFARË ËSHTË TURPI?

Dijetarët e muslimanë, duke iu referuar argumenteve të sakta (Kuranit dhe Sunetit), kanë thënë se turpi është një vlerë morale, që e nxit dhe e motivon njeriun për t'i kryer tri gjëra:

I. E shtyn njeriun për të kryer punë të mira.

II. E motivon dhe e stimulon njeriun që të largohet nga punët e këqija dhe të pahijshme.

TURPI ËSHTË PREJ BESIMIT

III. E motivon dhe nxit njeriun që t'i kryejë obligimet ndaj çdokujt që ka detyra dhe obligime (duke filluar nga Krijuesi e pastaj ndaj krijesave).

DIJETARËT E KANË NDARË TURPIN NË TRE LLOJE

I. Turpi ndaj Allahut, realizohet duke ju bindur urdhëresave dhe ndalesave të Tij. Një ditë, Profeti (a.s) u drejtohet shokëve të tij duke u thënë: “Të keni turp prej Allahut, ashtu siç e meriton. – I thanë: - O i Dërguar i Zotit, të gjithë kemi turp prej Zotit. Pejgamberi (a.s) u përgjigj: - Nuk bëhet fjalë për atë që mendoni ju. Të kesh turp prej Zotit do të thotë të ruash kokën dhe çfarë ka në të, të ruash barkun dhe çfarë depërton në të, të kujtosh vdekjen dhe ikjen nga kjo jetë.”¹

II. Turpi ndaj njerëzve, është të përmbash vetën nga shqetësimi i të tjerëve, të mos sillesh keq me njerëzit, mos t'u thuash fjalë të pahijshme dhe mos t'i bezdisësh ata.

III. Turpi ndaj vetvetes, është që njeriu të jetë i moralshëm dhe i sjellshëm.²

DISA NGA DOBITË E TURPIT

1. Turpi është çelësi i çdo mbarësie. Ai është çelësi, që na nxit në adhurim dhe respekt ndaj Allahut, në pasimin e të Dërguarit të Allahut, respektimin e prindërve, mbajtjen e lidhjeve

1. Transmetuar nga Tirmidhiu.
2. Maverdi, Ebu'l-Hasan Ali b. Muhammed b. Habib el-Basri, Edebul-Dunja ved-Din, f. 392-393. Ikinci baski, Daru Ibn-i Kesir, 1990.

farefisnore, mbajtjen e fjalës, zbatimin e premtimit, nderimin e mysafirit, etj.

2. Turpi është moral, që Allahu i Madhëruar e do. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vërtet Allahu është i Turpshëm, Mbulues, e do turpin dhe mbulimin...”³

3. Turpi është prej cilësive të Allahut të Madhëruar. Prej cilësive të Allahut (xh.sh) është edhe “El-Hajijj”, siç përmendet në hadithin e Pejgamberit (a.s) ku thotë: “Allahu është i Turpshëm (Hajijj), Bujar; turpërohet kur robi i drejton duart drejt Tij, t'ia kthejë ato bosh.”⁴

4. Turpi është një moral i përbashkët i të gjithë Pejgamberëve. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ndër urtësitë e trashëguara nga Pejgamberët e mëparshëm është edhe fjala: Nëse nuk turpërohesh, atëherë bëj ç'të duash.”⁵ Nga ky hadith kuptojmë se kush nuk ka turp nuk ka gjë që e ndalon nga veprimi i punëve të këqija.

5. Turpi e ndihmon njeriun të largohet nga gjynahet.

6. Turpi e mbron njeriun nga koritja në dynja e në ahiret, sepse turpi vendos mburojë dhe pengesë mes njeriut dhe rrugëve që çojnë deri në gjynahet.

7. Turpi është zbukurimi më i mirë. Njeriu nuk mund të zbukurohet me diçka më të mirë sesa turpi...Pejgamberi (a.s)

3. Transmetuar nga Ebu Daudi, Nesaïu dhe Imam Ahmedi.
4. Transmetuar nga Ebu Daudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Imam Ahmedi.
5. Transmetuar nga Buhariu.

“NDËR URTËSITË E TRASHËGUARA NGAJ PEJGAMBERËT E MËPARSHËM ËSHTË EDHE FJALA: NËSE NUK TURPËROHESH, ATËHERË BËJ Ç'TË DUASH.”

ka thënë: “Fuhshi (të folurit keq) nuk ndodh të jetë prezent në diçka e të mos e shëmtojë atë, ndërsa turpi nuk ndodh të jetë prezent në diçka e të mos e zbukurojë atë.”⁶

8. Turpi është iman. Nga Ibn Omeri (r.a) transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Turpi dhe besimi janë shokë (të pandarë). Kur humbë njëri, humbë edhe tjetri.”⁷

SI TA PËRVETËSOJMË MORALIN E TURPIT?

1. T'i mësojmë vlerat e turpit që kjo të na nxisë ta përvetësojmë atë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Turpi është prej imanit.”⁸ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Turpi është pjesë e imanit, e imani të shpie në xhenet.”⁹

Nga nëna e besimtarëve, Aisheja (r.anha) transmetohet se ka thënë: “Hyja në shtëpinë ku u varrosën i Dërguari i Allahut dhe babai im. Aty nuk mbulohesha tërësisht, dhe thoja: “Këta janë bashkëshorti im dhe babai im.” E më vonë kur u varros Omeri (r.a), pasha Allahun, sa herë që kam hyrë, jam mbuluar tërësisht, nga turpi prej Omerit (r.a).”¹⁰

Omeri (r.a) ka thënë: “Kujt i pakësohet turpi, i pakësohet devotshmëria. E kujt i pakësohet devotshmëria, zemra i vdes.” Po ashtu ka thënë: “Kush turpërohet, fshihet (nga turpi prej njerëzve). Kush fshihet, e ruan veten. Ndërsa kush e

6. Transmetuar nga Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Imam Ahmedi.
7. Transmetuar nga Buhariu në Edebul-Mufred, Hakimi në Mustedrek dhe Bejhakiu në Shuabul-Iman.
8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
9. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.
10. Transmetuar nga Imam Ahmedi.

ruan veten, do të ruhet (nga Allahu).” Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Turpi është i gjithi mirësi.”¹¹

2. Të largohemi nga gjërat të cilat e largojnë turpin, si: fjalët e këqija e të ulëta, sharja, fyerja, mallkimi, gënjeshtra, etj.

3. Forcimi i imanit (besimit), e kjo arrihet me shumimin e veprave të mira. Turpi është fryt i imanit kur imani shtohet, automatikisht shtohet edhe turpi.

4. Të përjetosh mbikëqyrjen e Allahut. Hatim El-Esammî ka thënë: “Bëja kusht vetes tri gjëra: Kur të vepros diçka, kujtoje shikimin e Allahut ndaj teje; kur të flasësh, kujtoje dëgjimin e Allahut ndaj teje; kur të heshtësh, kujtoje diturinë e Allahut ndaj teje.”

5. Përzierja me njerëzit e mirë, takimi, dëgjimi dhe qëndrimi me ta. Disa dijetarë kanë thënë: “Ngjalle turpin duke u shoqëruar me ata prej të cilëve turpërohen të tjerët.” Muxhahidi ka thënë: “Nëse një mysliman nuk përvetëson diçka prej vëllait të vet, përveç asaj që turpi prej tij ta pengojë nga gjynahet, kjo do t'i mjaftonte.”

6. Të përkujtuarit se si ishte turpi i shembullit më të lartë të njerëzimit, të Dërguarit të Allahut, sahabëve të tij dhe më pas të atyre që i pasuan ata.

Fjala turp në gjuhën arabe d.m.th “El-Haja” gjithashtu fjala “Hajat” në arabisht do të thotë jetë. Ibn Kajjimi ka thënë: “Për sa kohë që do të ekzistojë turpi tek njerëzit dhe shoqëria, për aq kohë do të ketë jetë e gjallëri tek ata. Kur turpi të zbehet, do të zbehet dhe dobësohet edhe jeta e tyre.”

11. Transmetuar nga Muslimi.

“KUJT I PAKËSOHET TURPI, I PAKËSOHET DEVOTSHMËRIA. E KUJT I PAKËSOHET DEVOTSHMËRIA, ZEMRA I VDES.”



Ajni Sinani
Teolog, Prizren

JAVA E KRENARISË! ÇFARË KRENARIE?!

Java e krenarisë! Çfarë krenarie?! Ku e gjetët ju këtë krenari?! Në cilin libër të Zotit?! Devijimet s'mund të jenë krenari!

Ato duhet të trajtohen me kujdes dhe mjekësisht. Këta që martohen me të njëjtës gjini pse duhet kaq trumbetisht të promovojnë një javë krenarie! Eh Zot sa poshtë ka rënë një pjesë e krijesave Tua.

Ku mbeti feja, ku mbeti nderi?! Ku mbeti tradita e zakoni?! Si popull jemi krenu e dallue për disa vlera morale e hyjnore por kjo krenari (!) e fundit nga na doli?!

Pastaj prej nga ky slogan krenari në shtëpi krenari në qeveri. Neve na bën krenar një Qeveri që punon për popullin. Jo një Qeveri që promovon devijimin! Askush s'po largohet nga Kosova se s'mund të martohet me gjininë e njëjtë.

Sa është numri i këtyre njerëzve?! Po detyrohen me sjellë njerëz nga vendet përreth me na bind se këta janë një komunitet dhe në numër! Rinia po ikë sepse s'ka perspektivë. Me slogane boshe nuk përparon vendi. Përzgjedhja jonë si popull duhet të jetë selektive.

Të marrim vlerat dhe virtytin dhe të anashkalojmë devijimet dhe veset që bien ndesh me traditat tona dhe mësimet hyjnore.

Ku mbeti feja, ku mbeti nderi?! Ku mbeti tradita e zakoni?! Si popull jemi krenu e dallue për disa vlera morale e hyjnore por kjo krenari (!) e fundit nga na doli?!

KONKURSI I 10-TË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE TË SHKODRËS

AKTIVITETI I MADH I KONKURSI TË 10-TË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE TË SHKODRËS

Ditën e shtunë paradite, më 25 qershor 2022, në ambientet e kompleksit “Zmijani”, Myftinia Shkodër organizoi, përmes sektorit të arsimit, aktivitetin e madh të Konkursit të 10-të vjetor midis kurseve fetare, që zhvillohen në xhamitë e Shkodrës.

Ky aktivitet madhështor mbledhi mbi 750 nxënës nga 45 xhami të qytetit dhe fshatit, dhe sipas programit të parashikuar, filloi me fjalën e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi iu uroj mirëseardhjen nxënësve frekuentues sistematikë të mejtepeve të xhamive, u foli për rëndësinë që ka kjo ditë e veçantë për ta, tashmë e kthyer në traditë, që frymëzon besim, adhurim, edukatë, kulturë, respekt, atdhedashuri, traditë, vëllazëri dhe harmoni me të gjithë.

Aktiviteti i konkursit të madh fetar u shoqërua me veprimtari të shumta sportive e zbavitëse si dhe lojëra

animatore në ambientet e kompleksit, të menaxhuar nga tre mësues të fushës sportive.

Gjithashtu, në program kishte edhe recitime me poezi, ilahi, këndim nga Kur’ani Famëlartë, etj, si dhe Konkursi i përvitshëm mes nxënësve të xhamive të të gjithave mejtepeve/kurseve fetare. Në përfundim të konkursit, u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga imamët Naim Drijaj, Ervil Kuçi dhe Besim Barbullushi, vendosën në bazë të pikëve të marra nga secili konkurrues, për çmimin e parë: Nejla Hasaj, xhamia Dragoç; çmimi i dytë: Unejs Heta, xhamia Mjedë; dhe çmimi i tretë: Selam Fangaj, xhamia Bardhaj.

Ndërsa çmimi për zërin e bukur në leximin e Kur’anit u shpall nxënësi Erigers Tahiri, xhamia Ganjollë.

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër vlerësoi edhe me çmime inkurajuese (fletë lavdërimi) për nxënësit që spikatën gjatë konkursit fetar dhe gjithashtu të dalluar në procesin mësimor të kurseve fetar.



TURKMENISTANI

Turkmenistani është një shtet që ndodhet në jugperëndim të rajonit të Azisë Qendrore. Ky vend kufizohet me Kazakistanin në veriperëndim, Uzbekistanin në veri dhe lindje, Afganistanin në juglindje, Iranin në jug dhe me Detin Kaspik në perëndim.

Turkmenistani është shteti i dytë më i madh në Azinë Qendrore, pas Kazakistanit, dhe është shteti më jugor nga pesë republikat e rajonit.

Turkmenistani ka një sipërfaqe prej 491.210 km², dhe një popullsi prej 6.207.775 banorësh (sipas worldometers.info, qershor, 2022)

Kryeqyteti i Turkmenistanit është Ashgabat.

GJEOGRAFIA

Katër të pestat e Turkmenistanit përbëhet nga pjesa jugore e ultësirës së Turanit. Malet dhe ultësirat gjenden kryesisht në pjesën jugore të republikës, përfshirë vargmalet Köýtendag dhe Kopet-Dag.

Në të gjithë Turkmenistanin mund të shihen dy ndarje të gjera, ku njëra është rajoni oaz - i karakterizuar nga furnizimi i mjaftueshëm me ujë, me toka të kultivuara dhe industri të zhvilluar - i përbërë nga: oazi Kopet- Dag, oazi Morghāb, oazi Tejen, oazi i mesëm Amu Darja dhe oazi i poshtëm i Amu Darja.

Rajoni tjetër është ai i shkretëtirës, që zë nëntë të dhjetat e territorit të Turkmenistanit, i ndarë në Turkmenistanin perëndimor dhe shkretëtirën Karakum. Shkretëtira Karakum është një nga shkretëtirat më të mëdha në botë, që zë gjithë pjesën qendrore të Turkmenistanit, kurse në veri ajo shtrihet drejt Kazakistanit. Shkretëtira e Turkmenistanit perëndimor është një hapësirë e madhe dhe pothuajse pa ujë, por pjesa e saj malore, e cila është vazhdim i maleve të Kaukazit, ka burime minerale dhe lëndë djegëse. Në malet Kaukaze gjenden depozita të rëndësishme të naftës, kripës së gurit dhe kripës së zakonshme.

Lumenjtë kryesorë të Turkmenistanit janë: Amu Darja (lumi i lashtë Oxus, i cili rrjedh përgjatë kufirit verilindor drejt Detit Aral), Tejen, Morghāb, dhe Atrak... siç ka edhe lumenj të shumtë

të vegjël malorë.

Tokat më pjellore – dhe ende të papërdorura sa duhet – shtrihen kryesisht në jug, verilindje dhe perëndim, ndërkohë që lumenjtë kryesorë rrjedhin kryesisht në lindje. Kanali i Karakumit në Turkmenistan, i përfunduar në vitin 1967, është një nga kanalet më të mëdha të ujitjes dhe transportit në botë.

KLIMA

Pozicioni i Turkmenistanit thellë brenda Azisë, dhe karakteri i relievit të tij, janë përgjegjës për një klimë të theksuar kontinentale, e cila shfaq

EKONOMIA

Ekonomia e Turkmenistanit bazohet në bujqësi dhe në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, ku këto tri fusha janë të zhvilluara mirë. Vendi ka të zhvilluara industri të rëndësishme kimike, transformuese dhe ushqimore.

Bujqësia në Turkmenistan bazohet kryesisht në projektet vaditëse. Toka e përgjithshme bujqësore arrin në gjashtëqind mijë hektarë, e përshkruar nga shumë kanale vaditëse. Kulturat më të rëndësishme atje janë drithërat dhe pambuku, kurse dhentë përbëjnë pasurinë më të madhe të sektorit të blegtorisë.



luhatje të mëdha të temperaturave gjatë ditës dhe vitit. Temperatura mesatare vjetore atje është 14–16 °C, por kjo shifër maskon një gamë jashtëzakonisht të gjerë. Gjatë ditëve të verës, temperatura rrallë bie nën 35 °C, kurse temperatura maksimale absolute e lartë në Karakumin juglindor arrin 50 °C, nën hije. Në të kundërt, në dimër, në skajin jugor të vendit, në Serhetabat (në kufirin me Afganistanin), temperatura bie në -33 °C. Reshjet bien kryesisht në pranverë, dhe variojnë nga rreth 80 milimetra në vit në shkretëtirën veriperëndimore, deri në rreth 300 milimetra, në male.

Nafta nxirret pranë detit Kaspik, dhe prodhimi vjetor i kalon gjashtëmbëdhjetë milionë tonet, kurse sasia e gazit natyror të nxjerrë arrin deri në tre milionë ton në vit.

Në Turkmenistan gjenden pesë rajone ekonomike: 1. Rajoni qendror - Ashgabat - që është një rajon bujqësor dhe industrial; 2. Rajoni perëndimor - Krasna Vodsk - i cili është një rajon industrial, prodhues i naftës, i gazit dhe i kimikateve; 3. Rajoni juglindor - Mary - është një rajon bujqësor; 4. Rajoni lindor - Chargo - është një zonë industriale dhe bujqësore; 5. Rajoni verior - Tachos - që është një rajon bujqësor.

GJUHA

Turkmenistani flet një gjuhë që i përket degës jugperëndimore ose Oguze të grupit gjuhësor turk. Kështu, kjo gjuhë është më e lidhur me turqishten sesa me Uzbeke apo me gjuhën Kazake. Që nga viti 1993, kjo gjuhë është shkruar me alfabet latin. Rusishtja është gjuha kryesore e gati një të tetës së popullsisë, dhe flitet gjerësisht si gjuhë e dytë, por përdorimi i saj ka rënë ndjeshëm që nga pavarësia.

FEJA

Sipas një raporti të Qendrës Kërkimore Pew, të vitit 2009, në Turkmenistan, 93,1% e popullsisë janë myslimanë. Tradicionalisht, turkmenët e Turkmenistanit janë myslimanë sunitë, të shkollës Hanefi. Në Turkmenistan ekzistojnë gjithashtu disa pakica të krishtera ortodokse, të kombësive ruse, ukrainase dhe armene.

HISTORI

Historia e Turkmenistanit filloi tradicionalisht me ardhjen e fiseve iraniane indo-evropiane, rreth vitit 2000 para Isait (a.s.). Fiset e hershme atje ishin nomade ose gjysmë nomade, për shkak të kushteve të thata të rajonit që penguan adoptimin e gjerë të bujqësisë. Disa nga fiset e vjetra të Turkmenistanit janë pjesë të fiseve të njohura iraniane përfshirë Massagatae, Sakas dhe Sogdianët e hershëm. Turkmenistani ishte një pikë kalimi për shumë migrame dhe pushtime të bëra nga fiset e ndryshme, të cilat u

KRYEQYTETI, ASHGABAT



tërhoqën drejt rajoneve të banuara të jugut, përfshirë Mesopotaminë e lashtë, Elamin dhe Qytetërimin e Luginës së Indus-it.

Historia e shkruar e rajonit fillon me pushtimin e tij nga perandoria Achaemenide e Iranit të lashtë, pasi rajoni ishte i ndarë midis satrapeve të Margianas, Chorasmias dhe Parthias. Pushtuesit e mëvonshëm do të ishin: Aleksandri i Madh, Parni, Eftalitët, Hunët iranianë, Göktürkët, Sarmatët dhe Iranianët Sasanid.

Gjatë kësaj faze të hershme të historisë, shumica e banorëve të Turkmenistanit ishin adhures të Zoroastrianizmit dhe Budizmit, dhe rajoni ishte kryesisht i dominuar nga popujt iranianë. Këto pushtime nga ato mbretëri të ndryshme, dhe këto

epoka, edhe pse thelbësore, nuk patën aq ndikim në formësimin e historisë së rajonit, sa e patën dy grupet e mëvonshme që erdhën atje: arabët myslimanë dhe turqit oghuzë.

Arabët myslimanë arritën atje në shekullin e 7-të të erës sonë, dhe Islami u përhap në shumicën e fiseve turkmene. Në shekullin e nëntë dhe të dhjetë të erës sonë, Tahiridët dhe më pas Samanidët, dominuan vendin. Në këtë kohë u shfaqën fiset e Oguzëve, të cilët u konvertua në Islam, dhe që më pas formuan Shtetin Selxhuk. Nën hijen e këtij shteti, u bë një përzierje mes fiseve të ndryshme, ku emri Oguz u zhduk gradualisht dhe u zëvendësua me emrin Turkmen, emërtim i cili u vendos dhe u përhap.

Shumica dërrmuese e banorëve u

XHAMIA (GYPAK) TÜRKMENBAŞI RUHI - ASHGABAT





**XHAMIA ERTUGRUL GAZI
NË ASHGABAT**

konvertuan në Islam. Gjithashtu, oguzët sollën fillimet e gjuhës turke- turkmene, e cila dominoi zonën. Periudha turke ishte një kohë e shkrirjes dhe rritjes kulturore. Traditat Islame të sjella nga arabët muslimanë, u bashkuan me kulturat lokale iraniane, dhe qyteti Merv u bë një qendër e tregtisë, shkencës dhe inovacionit, duke qenë një kryeqytet me ndikim i disa kalifateve islame.

Peizazhi kulturor i Turkmenistanit u ndryshua më tej nga pushtuesit dhe sundimtarët turq, si Selxhukët. Me pushtimin e Xhengis Khanit të shtetit Selxhuk, shumë fise turkmene migruan në veri dhe veri-lindje të vendit. Kjo u pasua nga pushtimi i vendit nga Timur Leng, dhe nga shtrirja e ndikimit të Khanatit të Buharasë dhe Khivas në lindje dhe në jug të vendit, si dhe nga shtrirja e ndikimit të safavidëve iraniane në të. Megjithatë, që nga shekulli i 16-të, elementi turkmen dominoi në të gjitha pjesët e vendit, përfshirë Pllajën Ustyurt dhe Mangelab.

Me fillimin e marrëdhënieve të forta tregtare dhe politike me Rusinë cariste nga njëra anë, dhe si rezultat i konfliktit fisnor dhe konfliktit me vendet fqinje (Iranin) nga ana tjetër, disa fise turkmene iu drejtuan rusëve për ndihmë, kështu që rusët dërguan një ushtri të madhe që u vendos në qytetin Krasna Vodsk, i cili ishte një kamp ushtarak për ta. Prej aty, rusët u

nisën në lindje, për të pushtuar në vitin 1882, të gjithë vendin.

Gjatë epokës bolshevikë, në vitin 1924 pushteti iu transferua komunistëve. Pas rënies së komunizmit, vendi fitoi pavarësinë më 27 Tetor të vitit 1991, dhe mori emrin Turkmenistan.

SI ERDHI ISLAMI NË TURKMENISTAN

I Dërguari i Allahut – paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të – ka thënë: “Ka për të mbërritur kjo çështje (Islami) kudo që arrin dita edhe nata. Zoti nuk lë shtëpi prej balte as prej lëkure pa e futur brenda saj këtë fe ... me nderim, ose poshtërim... nderim, me të cilin Zoti e lartëson atë që pranon Islamin... ose poshtërim, me të cilin Zoti e poshtëron atë që qëndron në mosbesimin.”

Temim Ed-Dari (r.a) i cili e transmeton këtë hadith dhe që më përpara kishte qenë i krishterë, tregon: “Këtë gjë e kam parë në njerëzit e familjes sime. Ata të cilët e përqafuan Islamin, ata më pas përjetuan mirësi, nderim dhe lavdi. Kurse ata prej tyre që qëndruan mosbesimtarë, ata i goditi poshtërimi, dobësia dhe xhizja.” [Ahmedi]

Ardhja e Islamit në Turkmenistan është e lidhur me ardhjen e tij në rajonin e Khorasanit. Gjatë epokës së kalifit

Omer ibnul-Hattab (r.a), El-Ahnef ibn Kajs mbërriti në rajon dhe mori qytetin Merv, i cili është një nga qytetet e Turkmenistanit tani.

Në kalifatin e Othman ibn Affan-it (r.a), Abdurrahman ibn Amir u emërua guvernator i Basrës, kështu që në vitin 30

hixhri, ky e dërgoi El-Ahnef ibn Kajs në një betejë tjetër, dhe ai arriti në Takharistan, në krye të lumit Amu Darja, shkoi përtej qytetit Merv, dhe e mundi aleancën e Tokharistanëve. Emir ibn Ahmed u bë guvernator i Merv-it, dhe arabët u vendosën të banojnë atje. Nga mesi i shekullit të parë hixhri, Islami kishte vendosur shtyllat e tij në qytetin Merv, dhe muslimanët e bënë atë si bazë për lëvizjet e tyre në rajonin përtej lumit.

Në vitin 55 hixhri, Said ibn Othman (r.a) e kaloi lumin Amu Darja, bashkë me forcat muslimane, për të marrë zonat përtej këtij lumi.

Kur Kutejbe ibn Muslimi zhvilloi luftimet e tij në Ferghana dhe Kashgar dhe i mori ato, ai më pas e përdori qytetin Merv si bazë për misionet e tij luftarake, dhe ky ishte roli i rajonit turkmen në përhapjen e Islamit në Azinë Qendrore.

Gjatë kalifatit të El-Me'mun-it Abasid, Tahiridët e zgjeruan ndikimin e tyre mbi Khurasanin dhe rrethinat e tij. Pastaj u krijua Shteti Samanid, në Epokën e Dytë Abaside, dhe Merv ishte një nga provincat e lidhura me të. Ndikimi i samanidëve u rrit gjatë sundimit të kalifit abasid El-Mu'temid, kur Ahmed ibn Nasr Es-Samani u emërua prijës i 'vendeve përtej lumit', dhe konsolidimi i Islamit u rrit në rajonin e Azisë Qendrore.

Në shekullin e 6-të hixhri, në vend të Samanidëve u krijua shteti Ghaznavid, i cili shtriu ndikimin e tij në Khurasan dhe Azinë Qendrore. Më pas në skenë doli roli i Selxhukëve turkmenë, të cilët e morën rajonin e Turkmenistanit si bazë të tyre. Kështu, ndikimi i tyre u shtri deri në Khurasan, në Azinë Qendrore dhe atë Perëndimore... madje ndikimi i tyre arriti deri në Bagdad.

Më pas, Mongolët morën kontrollin e Azisë Qendrore dhe të asaj Perëndimore, dhe pas konvertimit të tyre në Islam, ata morën përsipër të përhapin Islamin edhe më tej, mes popujve të Azisë Qendrore.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://worldometers.info/>
<https://ar.wikipedia.org>
<https://www.marefa.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.alukah.net>

SHQIPTARËT (ARNAUTËT) NË SIRI

Emigrimi i shqiptarëve në Siri filloi rreth 200 vjet më parë, në kohën e mbretërimit të Ibrahim Pashës, djalit të sundimtarit shqiptar të Egjiptit Muhamed Ali Pasha, kur ushtarët shqiptarë nuk u kthyen me ushtrinë në Egjipt dhe u vendosën në Siri.

Në atë kohë, nga Egjipti në Siri u shpërngulën nga 100 deri në 200 familje shqiptare dhe konsiderohet si grupi i parë i shqiptarëve të vendosur në Siri, sipas shkrimtarit siriano-shqiptar Abdul Latif Arnaut.

Vite më pas ndodhën edhe shpërngulje tjera, të fundit ishin ato të viteve 30-të.

Ata edhe sot e kësaj dite ruajnë me fanatizëm traditat tona.

INTEGRIMI NË SHOQËRI NUK UA FSHIU PËRKATËSINË SHQIPTARE

Emri "Arna'ut" ose "Arnaud" u referohet banorëve të Shqipërisë dhe gjatë sundimit osman të vendeve arabe, shumë nga njerëzit e kësaj kombësie emigruan në shtetet turke dhe u vendosën atje, dhe disa prej tyre e ruajtën mbiemrin e tyre Al-Arnat, kështu që ata njihen në Siri nga pseudonimet e tyre.

DISA ZAKONE TË VEÇANTA

Gjyshja e Ajmenit flet rrjedhshëm shqip, ndryshe nga gjyshi i tij, i cili e flet gjuhën, por nuk e zotëron atë në mënyrë të përsosur, më pas, gjyshërit e kanë ndërprerë mësimin e gjuhës shqipe në familje, për shkak të dështimit të përpjekjeve të tyre për t'ua përcjellë



DAMASKU

atë nipërve dhe mbesave mungesa e përpjekjeve të tyre për ta mësuar atë.

Ejmeni theksoi se gjyshja e tij ruan ende disa zakone shqiptare, si p.sh përgatitja e llojeve të vakteve (ushqimeve) në mbledhjet familjare, ku më e dallueshme është vakti "pita", i cili përbëhet nga 14 shtresa patate të skuqura brumi, të furnizuara me një tabaka dhe të mbushura me mish, djathë ose vezët, përveç "spisa." E cila përbëhet nga kos, hudhër dhe piper të skuqur.

Këto zakone nuk ndryshojnë shumë në familjen e Muhamed Arnautit, i cili është me origjinë shqiptare dhe ka lindur në kryeqytetin sirian, Damask.

Muhamedi, një anëtar i gjeneratës së tretë të familjes me origjinë shqiptare, i tha Enab Baladiut se babai i gjyshit të tij erdhi në Siri, pasi emigracioni i tij nga Shqipëria do të ishte drejt Turqisë, por "prirjet fetare" kontrollonin zgjedhjen e destinacionit të emigracionin, duke

pasur parasysh përshkrimin e tyre të Damaskut në atë kohë si "Sham Sherif".

Familja e Muhamedit i përket një grupi emigrantësh, disa prej të cilëve u vendosën në qytetin e Alepos (Halebit), në lagjen "Arnaut" në zonën e Kadamit dhe në zonat Divanije dhe El-Muhaxhirin në kryeqytet, Damask.

"Për fat të keq, ne nuk e flasim gjuhën shqipe në shtëpitë tona dhe personalisht unë di vetëm dy fjalë të gjuhës", thotë Muhamedi, i cili konfirmoi se gjuha zhduket brez pas brezi, por zhdukja e gjuhës nuk fsheh. Perceptimi i shqiptarëve në Siri, i cili është i pranishëm në shumicën e tyre, për kthimin në atdheun e tyre." Muhamedi shtoi: "Deri tani kemi një përkatësi që nuk e humbim dhe mall për Kosovën".

Sipas të riut, shqiptarët sirianë nuk e kanë problem të martohen jashtë familjeve dhe jashtë origjinës së tyre, me dëshmi se nëna e tij është damaskenase dhe zakonet janë bërë njësoj për shkak të të jetuarit në një komunitet.

PROFESIONI I RIPARIMIT TË ORËVE

Shqiptarët në Damask janë të famshëm për punën në profesionin e riparimit të orëve, sipas Muhamedit, edhe pse agjenti i orëve Casio në Damask është shqiptar.

Profesionin, Muhamedi, krahas studimeve universitare, e ka trashëguar nga gjyshi dhe daja i tij, të cilët punojnë në këtë fushë.

www.enabbaladi.net

Përktheu dhe përshtati:

Baki Shala



HALEBI (ALEPO)

MBRËMJE FETARE DHE KULTURORE NË OBORRIN E XHAMISË “EBU BEKËR”

Të xhumanë, më 27 maj 2022, pas faljes së namazit të akshamit, në oborrin e xhamisë së madhe, “Ebu Bekër”, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi një mbrëmje fetare dhe kulturore me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve/mejtepeve fetare të xhamive Ura e Bunës, Bardhaj dhe Mes-Myselim.

Fillimisht, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni i uroi mirë se ardhjen fëmijëve dhe të rinjve të këtyre xhamive, i cili tha se Myftinia në këtë sezon veror do të organizojë herë pas here aktivitete dhe veprimtari arsimore, kulturore dhe argëtuese.

Më pas, fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, cili shprehu kënaqësinë për organizmin dhe pjesëmarrjen në këtë aktivitet të veçantë, ku nënvizoi se qëllimi i këtyre mbrëmjeve fetare dhe i shfaqjes së një dokumentari mjaft interesant: “Triumfi i ezanit të minareve” është të tregojmë krenarinë e besimit dhe historinë e fesë tonë që nuk duhet me i neglizhu dhe nuk duhet kurrë me e harru për asnjë arsye. Pikërisht, ky dokumentar është tregues i një thesari dhe pasurie të çmuar, plot gjurmë të vyera të baballarëve dhe



prijësve tanë fetarë, të cilët edhe në momentet më të vështira të jetës së tyre..., ata nuk u dorëzuan asnjëherë, por qëndruan dhe kontribuan për të sjellë këtë liri të besimit dhe të identitetit tonë fetar dhe sigurisht dhe kombëtar që e gëzojmë dhe e përjetojmë të gjithë së bashku...

Në vijim, pjesëmarrësit ndoqën me kureshtje dhe vëmendje dokumentarin “Triumfi i ezanit të minareve”, si një mënyrë reflektimi për të mësuar e kuptuar se sa rëndësi ka besimi dhe feja të njeriut, pavarësisht privimeve dhe barrikadave që sjellin padrejtësisht sistemet brutale dhe kriminale siç ishte



ajo e regjimit barbar komunist.

Aktiviteti i kësaj mbrëmje të këndshme u mbyll me një koktej, si dhe me faljen e namazit të jacisë.

KORRIGJIM!

Në numrin e kaluar, maj 2022, nr. 231, tek kronika “Përshpirtje Ramazani” - Aktivitet rreth atmosferës së Ramazanit 1443/2022, f. 18, fotot ilustruese janë vendosur gabim, sepse janë fotot e aktivitetit “Mbrëmje fetare dhe kulturore në oborrin e xhamisë “Ebu Bekër”, të kësaj kronike në këtë numër, f. 16.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Redaksia

NDAHET NGA JETA H. HAJRULLAH JAKUPI, IMAM I XHAMISË LUARËZ

Ditën e xhuma, më 10 qershor 2022 në praninë e shumë familjarëve, imamëve, teologëve, besimtarëve, miqve dhe dashamirëve nga brenda dhe jashtë Shqipërisë, pas faljes së xhenazës në xhaminë e Kirasit, u përcoll me nderim dhe ngushëllimet më të sinqerta, i nderuari Haxhi Hajrullah Jakupi, imam i xhamisë Luarëz, Njësia Administrative Velipojë.

I pranishëm në këtë xhenaze ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili gjatë një fjalimi që mbajti para qindra besimtarëve tha se kontributet e H. Hajrullah Jakupit, kanë vijuar pandërprerje gjatë 32 viteve, pas rihapjes së besimit në vendin tonë, sikurse do të vijojnë si udhëzime e këshilla veprat e tij, përmes kujtesës dhe trashëgimisë familjare brez pas brezi.

Në mes të tjerave Myftiu tha: “Dëshmia e kësaj xhenaze nuk është asgjë tjetër vetëm se një shenjë e respektit të madh që ka lënë në zemrën e gjithsecilit prej nesh, i nderuari Haxhi Hajrullah Jakupi, i cili ka



H. Hajrullah Jakupi

qenë një burrë i nderuar dhe një imam dhe kujdestar i një xhamie shembullore si dhe pinjoll i një familjeje të nderuar, edukuar me mësimet e Kur'anit brez pas brezi, brenda familjes së tij, por edhe fëmijë të të gjitha moshave gjatë misionit të tij, si prijës fetar në xhamitë e Zotit”.

Kujtojmë, se H. Hajrullah Jakupi, Allahu e mëshiroftë, në aspektin fetar ka studiuar dy vite në Medresenë e Tiranës (1965-1967, pra deri në vitin që u mbyll feja me ligjet famëkeqe dhe kriminale komuniste), dhe pas rihapjes së fesë në vitin 1990, ka studiuar në kursin e kualifikimit të imamëve, për 6 muaj në



Stamboll të Turqisë.

Ai ka shërbyer 31 vite në mënyrë të vazhdueshme si imam dhe kujdestar xhamie në Luarëz, duke qenë vazhdimisht nismëtar kryesor për mirëmbajtjen e xhamisë, mbarëvajtjen e aktivitetit fetar si dhe mësimdhënien në mejtepet fetare, pikërisht nga viti 1991 deri që dorëzoi shpirtin e tij tek Krijuesi i Gjithësisë.

Myftinia Shkodër ngushëllon gjithë besimtarët, veçanërisht familjarët e H. Hajrullah Jakupit dhe i lutet Zotit të Madhëruar ta falë e ta mëshirojë imamin e nderuar dhe ta bëjë prej banorëve të xhenetit.

MYFTIU PRITI DREJTUESIT E UMAD, TURQI

Ditën e shtunë, më 11 qershor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, një delegacion të Shoqatës Ndërkombëtare të Dijetarëve Myslimanë (UMAD) nga Turqia, i kryesuar nga prof. dr. Abdulvehab Ekinxhi.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu u njoh me aktivitetin e UMAD dhe njëkohësisht i bëri një prezantim vëllezërve, ku i njohu me Shkodrën dhe aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe sfidat aktuale.



Ditën e enjte, më 16 qershor 2022, Imam Didmar Faja, Kryetar i KMSH në Arizona, njëkohësisht imam i UICA, në shoqëri të Myftiut të Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë përhapimi në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Dr. Bardh Spahia.

Me rastin e kësaj vizite u këmbyen urime dhe lutje për mbarësi dhe sukses, për të mirën e përbashkët, për Shkodrën, shembujt pozitivë dhe kulturën që rrezaton, edhe përtej oqeanit.

IMAM DIDMAR FAJA VIZITOI KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR



GANJOLLË, MYFTIU: “TA DËSHMOJMË ISLAMIN, TA MBROJMË TABANIN FETAR E KOMBËTAR!”

Pasditën e së shtunës, më 18 qershor 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi xhaminë e Ganjollës, ku u prit nga kujdestari dhe imami i saj, H. Erion Hasmegaj, i cili e njohu edhe me aktivitetet e kësaj xhamie, kursin fetar dhe përkundesjen e vazhdueshme për ta kthyer atë në një pikë referimi për banorët e zonës dhe vizitorët e shumtë.

I shoqëruar edhe nga përgjegjësi i sektorit të rinisë pranë Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi, Myftiu mbajti edhe një ligjëratë për besimtarët e pranishëm, ku dha udhëzimet dhe këshillat e tij.

Në fjalën e tij, Myftiu falënderoi përkushtimin e besimtarëve të Ganjollës për mirëmbajtjen e xhamisë, për rritjen e aktivitetit, për praninë e fëmijëve dhe të rinjve dhe promovimin e vazhdueshëm të vlerave islame, plot dinjitet e krenari.

Myftiu foli për rëndësinë e ruajtjes



së tabanit dhe identitetit islam, pa lëkundje e hezitim, duke thënë se përhapja e Islamit dhe dëshmimi i tij plot krenari, është obligim i dyfishtë për secilin prej nesh sot, obligim fetar dhe kombëtar, në kohën e sfidave të tjetërsimit dhe zhveshjes nga elementët e vlerave kryesore të tabanit fetar e atij kombëtar.



Ditën e hënë, më 20 qershor 2022, në ambientet e Qendrës Kulturore të Myftinisë Shkodër, filloi Kursi Veror, me pjesëmarrjen e rreth 30 fëmijëve të moshave 7 deri 10 vjeç.

Kursi Veror i organizuar nga Myftinia Shkodër, është një platformë e re e cila fokusohet në edukimin me dashurinë ndaj Krijuesit të gjithësisë, përmban aktivitete psiko-edukative përmes interaktivitetit dhe lojëra kreative përmes artit.

Krahas kësaj do të zhvillohen edhe pikiniqe, veprimtari kulturore, si dhe një herë në javë do të ketë mësim dhe argëtim në mjediset e xhamisë "Ebu Bekër".

Në hapjen e këtij Kursi Veror, mori pjesë, teologu Arben Halluni, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, i cili gjatë fjalës përshëndetëse, i uroj mirë se ardhjen fëmijëve/nxënësve në këtë aktivitet me karakter edukativ dhe zbavitës.

FILLOI KURSI VEROR "BUZ'QESH"



Ndërkaq, teologu Halluni falënderoi bashkëpunimin e mësueseve të përkushtuara të këtij Kursi Veror,

koordinatoren, teologen Zamira Bushati (Puka), znj. Admira Guri, psikologe dhe znj. Almeda Tusha, psikologe.

HAXHILERËT E SHKODRËS MARRIN UDHËZIMET DHE TRAJNIMET E HAXHIT



Ditën e martë, më 28 qershor 2022, në ambientet e xhamisë së Parrucës, Myftinia Shkodër nisi trajnimin e haxhilerëve të këtij viti.

Ligjërata e parë u mbajt nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili dha disa këshilla dhe udhëzime të mbushura me emocione, nëpërmjet të cilave sqaroi pozitën e lartë të adhurimit të Haxhit dhe dashurinë e Allahut për haxhilerët.

Më pas, murshidi i grupit të Shkodrës, teologu Esmir Selimi, shpjegoi domethënien e Haxhit, si dhe mënyrën e kryerjes së Umres, që i paraprin Haxhit.

Nëpërmjet detajeve të ilustruara dhe pyetjeve nga të pranishmit, u sqaruan detaje të rëndësishme, që i nevojiten çdo haxhiu për ditët e udhëtimit të tij.

Trajnimi dhe aktivitetet për nder të haxhilerëve vazhdojnë deri ditën e hënë, më 4 korrik 2022, kur të regjistruarit shkodranë për Haxhin e sivjetshëm do të marrin rrugën për në vendet e shenjta.

TAKIM ME IMAMËT E SHKODRËS NË HYRJE TË DITËVE TË DHUL-HIXHES



Ditën e enjte, më 30 qershor 2022, në ambientet e xhamisë së Parrucës u zhvillua mbledhja e radhës me imamët e xhamive të Shkodrës.

Mbledhja u drejtua nga teologu Arben Halluni, ku në vend të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari paraqiti udhëzimet për ditët e Dhul-Hixhes dhe sezonit veror, i cili në mes të udhëzimeve kërkoi që duke nisur nga dita e xhuma e datës 1 korrik 2022, dersi para xhumasë dhe hytbet të përqendrohen në hedhjen dritë mbi vlerën e kësaj periudhe të begatë, të ftohen besimtarët drejt pendimit, shtimit të adhurimeve, bamirësisë, ruajtjes së lidhjes

farefisnore, përmirësimit të komunikimit në komunitet, bërjes së kurbanit, etj.

Gjithashtu, teologu Halluni i kërkoi imamëve, që gjatë sezonit veror në bashkëpunim me sektorët e rinisë dhe të arsimit të ketë më tepër angazhim në mirëmbajtjen dhe hapjen e kurseve të reja fetare dhe edukative si dhe të zhvillohen aktivitete që ofrojnë të rinjtë dhe fëmijët me xhaminë dhe moralin e saj.

Gjatë mbledhjes pati edhe diskutime nga imamët në lidhje me rendin e ditës, si dhe u dhanë ide e sugjerime për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë dhe bashkëpunimit në mes besimtarëve dhe më të gjithë njerëzit vullnetmirë.

Dëshmia e Vakëfit

Vakëfi asht pasuri, nga thesari shpirtnor dhurohet, me madhnië e Allahut me çmim t' lart vlerësohet. Për atë që e dhuron, dëshmi do të jetë, shpërblimin e tij tek Allahu ka me gjetë!

Ai lihet që shoqnisë besnik ti qëndrojë, kushdo që e zvatë...randë do të gabojë!

Në mirëqenie të xhematit Vakëfi ndihmon, të zotin e tij në Ahiret e kërkon!

Sadaka e rrjedhshme që kurrë nuk humbet, kush e abuzon, kurrë hajr s' do të ketë!

O ju që Vakëfet plaçkit i kenë... kurrë mos harroni se përgjegjës jeni! Ato mund të 'merren' por nuk humbasin, atë që e dhuroi Melekët do ta thërrasin... Ai që e zhvati hesap të randë do t' ketë, në hall të madh 'Atë ditë' do të jetë.

Lënia e Vakëfit nga Iman i përsosur arrihet, se kush asht i tillë nga kjo vepër njihet.

O Allah na ban prej atyre që mundësi të kemi, dhurues të Vakëfeve edhe ne të jemi!

Vakëfi asht dëshmi për atë që e len, pranë madhnië s' Allahut atë e gjenë.

Gllabërimit të Vakëfeve askush mos t' i gëzohet, në zjarr të Xhehenemit do të dënohet.

Burhan Fili
College Station, Texas





MYFTINIA SHKODËR

Haxhi 1443 / 2022

HAXH TË PRANUAR HAXHILERËVE TË SHKODRËS, TË SHQIPËRISË DHE TË MBARË YMETIT ISLAM!

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“HAXHI I PRANUAR
nuk ka shpërblim tjetër,
VEÇSE XHENETIN!”**

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)



ME ZEMËR TË MIRË KURBAN BAJRAMIN!

E SHTUNË, 9 KORRIK 2022 | BAJRAMI FALET NË ORËN: 6.05

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org